

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Permiresim i infrastrukture kryesisht ne zone informale qe jane ne proces legalizimi,ne zona banimi me mungese sherbimesh si ujesjelles,kanalizime etj ose ku keto sherbime jane te papershtatshme”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45210000-7
Pune ndërtimi**

VLERA E FONDIT LIMIT: 52.650.234(pesedhjte e dy milion e gjashteqind e pesedhjte mije e dyqind e tridhjte e kater)lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor bashkia Vau Dejës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a)Formulari i ofertes sipas Shtojces 1

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç” (sipas Shtojces 1 te DST).

b.Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c.Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe nëVKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesiduhettëdorëzgjë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit i kontratës objekt prokurimi**. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 b) dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2020,2021,2022, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"i ndryshuar;

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar), Neni 5, gërma "c" ku citohet se: "...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale".

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, konkretisht në vlerën 26.325.117 (njëzet e gjashtë milion e treqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lek pa tvsh dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose,
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, konkretisht: 105.300.468 (njëqind e pesë milion e treqind mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë) lek pa tvsh.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit; *(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)*
- Çertifikaten e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit; *(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)*
- Çertifikaten e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
- Fatura tatimore të situacionit përfundimtar

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat..50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës

realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikava (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Janë kërkuar të njëjtat dokumenta si në rastin e punëve me sektorin publik ashtu edhe me sektorin privat, pasi këto punime kur kryhen me sektorin privat duhet të jenë të pajisur me leje infrastrukture (ose janë pjesë e lejes së ndërtimit) dhe si rrjedhojë operatori duhet të mbajë dokumentacionin teknik, ligjor dhe administrativ në të njëjtën mënyrë si në rastin e punëve me sektorin publik.

2.4. Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 A Punime germimi në toke me vlerë 9 027 646.47 lek pa TVSh.
- NP-4 B Rrugë autostrada, ura mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale me vlerë 23 762 985 pa TVSh
- NS-1 A Punime për prishjen e ndertimeve me vlerë 6 364 lek pa TVSh.
NP-7 A Ujësjiellës, kanalizime, veprakullimi e vaditjeme vlerë 11 419 188.69 pa TVSh.
- NP-11.A Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit, linjat e tensionit të lartë dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike me vlerë 2 367 340.2 lek pa TVSh.
- NS-13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni me vlerë 186 049 lek pa TVSh.
- N.S-6 A Sinjalistika rrugore jodriçuese me vlerë 3 373 506 lek pa TVSh.
- N.S-18 B Punime topogjeodezike me vlerë 26 046 232.1 lek pa TVSh.

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave

Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoritë e kërkuara janëkërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi I kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP-1	Punime germimi ne toke	<p>Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet Transport dheu me auto deri 5.0 km</p> <p>Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke Transport dheu me auto deri 1.0 km</p> <p>Shtrese rere 10 cm Mbushje me cakell</p> <p>Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke Transport dheu me auto deri 1.0 km</p> <p>Shtrese rere 10 cm Mbushje me cakell</p> <p>Germim dheu gropa per shtylla ndricimi toke mes. kat III sip. ~1.5m (0.075m³/cope)</p> <p>Germim kanale ne toke te bute me krah me seksion deri 0.75m² S-0.15m²</p> <p>Germim kanale ne toke te bute me krah me seksion deri 0.75m² S-0.3m²</p>	A - 0-20 milion lekë

		<p>Shtrese rere natyrore t=15cm (Rere e imet per mbulim tubacioni seksioni 1T-0.4ml)</p> <p>Mbulim kanali me material qe sistemohet lehte S-0.09m2</p> <p>Mbulim kanali me material qe sistemohet lehte S-0.175m3</p> <p>Germim dheu gropa per puseta betoni mes. kat III sip. ~1.5m (0.2m3/cope)</p>	
NP-4	<p>Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo</p> <p>Dhe pista aeroportuale</p>	<p>Cilindrim kasonete me rrul</p> <p>Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri t=20cm (mbushje dhe shtresa)</p> <p>Shtrese stabilizant t=10cm</p> <p>Shtrese stabilizant t=10cm per bankina</p> <p>Shtrese binderi me zall lavatrice t=5cm me makineri</p> <p>Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice t=3cm me makineri</p> <p>Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka</p> <p>Shtrese rere 4 cm</p> <p>Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur makineri</p> <p>F V bordura betoni 12x25 cm (rruge + trotuar)</p> <p>Shtrese betoni C 12/15 per fiksimin e bordurave</p>	B - 21-50 milion lekë
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve	<p>Prishje struktura ekzistuese betoni</p> <p>Prishje mure blloqesh betoni (mure rrethues)</p>	A - 0-20 milion lekë
NP-7	Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje	<p>Struktura monolite betoni C 20/25 (per kuneten anesore)</p> <p>F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm</p> <p>F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm</p> <p>Pusete shkarkimi b/a, 80 x 80 cm, h = 100 cm</p> <p>Pusete 1x1x1.5m</p> <p>F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm</p> <p>F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm</p> <p>Pusete b/a shiu 40 x 40 cm, h = 100 cm, me kapak zgare hekuri</p>	A - 0-20 milion lekë
NP-11	Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e tensionit të lartë dhe Tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike	<p>F.V. Shirit plastik me shenimin "kabllo elektrik"</p> <p>Beton C-16/20 per bazament e fiksimit trup ndriçuesi rrugor (0.175m3/cope)</p> <p>Beton C-16/20 per bazament BOX-TU Nr1-Nr10, ndricim rrugor (0.16m3/cope)</p> <p>Beton C-16/20 per mbrojtje tub plastik d-50/42mm, kalim rruge (0.22m3/cope)</p> <p>F.V. Rajzer zinkato per mbrojtje kabell TU+aksesore</p> <p>F.V. Kabell elektrik bakri FG16OR 3x1.5mm²</p> <p>F.V. Kabell elektrik bakri FG16OR 4x1.5mm²</p>	A - 0-20 milion lekë

		<p>F.V. Kabell elektrik bakri FG16OR 2x4.0mm²</p> <p>F.V. Kabell elektrik bakri FG16OR 2x6.0mm²</p> <p>F.V. Kabell elektrik bakri FG16OR 4x4.0mm²</p> <p>F.V. Kabell elektrik bakri FG16OR 4x6.0mm²</p> <p>F.V. Kabell elektrik bakri FG16OR 4x10mm²</p> <p>F.V. Panel elektrik metalik hermetik 60x40x100cm, per ndriçim rrugor</p> <p>F.V. Automat 4P/4M-20A 6kA magnetik termik</p> <p>F.V. Automat 1P+N/1M-20A 6kA magnetik termik</p> <p>F.V. Automat 1P+N/1M-16A 6kA magnetik termik</p> <p>F.V. Sinjalizues tensioni 220V-0.5Ë</p> <p>F.V. Siguresa te ndryshme 230V/1A, 2A sipas skemes</p> <p>F.V. Fotoelement komandim leshues 3F-20A</p> <p>F.V. Leshues tensioni komandim ndriçimi 3Fazor-20A</p> <p>F.V. Tub PVC flexibel i forte z.d D=50/42mm</p> <p>F.V. Tub PVC rigid i forte z.d D=110mm/s-2mm ne bazament betoni</p> <p>F.V. Shtylle metalike zinkato per ndriçues rrugor L-4.5m</p> <p>Furnizim ndricues rrugor led 1x40ë 6000° K, IP-67</p> <p>F.V. Kasete metalike IP-67 me automat 10A ne shtylle ndriçimi</p> <p>Montim ndricues rrugor led 1x40ë 6000° K, IP-67 ne shtylle 4.5m+detaj montimi</p> <p>F.V. Kapak metalik me mentesha 20x20cm puseta ndriçim rruge</p> <p>F.V. Kapak metalik me mentesha 40x40cm puseta ndriçim rruge</p> <p>F.V. Puntalina per percjelles 1.5, 2.5</p> <p>F.V. Puntalina per percjelles 4, 6, 10</p> <p>F.V. Percjelles bakri izolim PVC N07V-K 6 mm²</p> <p>F.V. Tub PVC flexibel i forte z.d D=32mm</p> <p>F.V. Elektroda tokezimi 5x5x0.5 L=150</p> <p>F.V. Kapikorda per percjelles tokezimi Ø6</p> <p>F.V. Shkeputes per matje tokezimi panel metalik</p>	
NS-13	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni	<p>F.V. Tub PVC flexibel i forte z.d D=50/42mm</p> <p>F.V. Shirit plastik me shenimin "kabllo elektrik"</p> <p>Beton C-16/20 per pusete betoni kapak metalik 50x50x60cm (0.2m³/cope)</p> <p>Beton C-16/20 per mbrojtje tub plastik d-50/42mm, kalim rruge (0.22m³/)</p>	A - 0-20 milion lekë

		F.V. Kapak metalik me mentesha 40x40cm puseta ndriçim rruge	
NS-6	Sinjalistika rrugore jodriçuese	Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikomponente (paste) F V tabela rrugore te ndryshme D=90cm	A - 0-20 milion lekë
NS-18	Punime topogjeodezike	Te gjitha punimet per rrugën dhe germimet	B 21-50 milion lekë

Klasifikimi sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

2.4.1 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te perfsjire ne licensen e shoqerise të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndertimi / drejtues Teknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik / drejtues teknik

Për secilin pjestar të stafit teknik te mësiperm duhet te paraqesë, Kontratë pune e vlefshme, diplomë / licencë/ certifikaten e kualifikimit.

Shënim: Për përmbushjen e kësaj pike operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8. Dokumentacioni i kërkuar më sipër do të paraqitet fizikisht përpara publikimit të njoftimit të fituesit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 5, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë

punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierit të ndërtimit, elektrik , mekanik hidroteknik, topograf, mjedisit është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Inxhinier Ndertimi – është i nevojshëm pasi do të merret me organizimin dhe menaxhim e punimeve, hartimin dhe mbajtjen e dokumentacionit teknik, ligjor dhe administrativ të objektit.

Inxhinier Elektrik – është i nevojshëm pasi në punimet ë parashikuara në kontratë kemi punime elektrike për ndriçimin e rrjetit rrugor si dhe në zonën ku do të kryhet investimi kalon kabulli 10 000V i cili vjen nga hidrocentrali, prandaj prania e e këtij inxhinieri si drejtues teknik për rradhën dhe mënyrën e kryerjes së punimeve është e domosdoshme.

2.4.2 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndertimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Topograf/ Gjeodet/ Markshajder
- 1 (një) teknik ndërtimi

Për të cilin duhet të paraqesë deklaratë që do të jetë i disponueshëm në kantier gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës dhe që nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

Në rast se inxhinieri i ndërtimit, drejtues teknik i kërkuar më sipër, paraqet deklaratë që nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i disponueshëm përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, inxhinieri i kërkuar si staf mbështetës nuk është e detyrueshmë të plotësohet.

Për secilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë, Kontratë pune e vlefshme, diplomë / licencë.

Shënim: Për përmbushjen e kësaj pike operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8. Dokumentacioni i kërkuar më sipër do të paraqitet fizikisht nga operatori fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë. Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.

Inxhinier Ndërtimi është i nevojshëm pasi do të merret me organizimin e punimeve krahas drejtuesit teknik, si dhe në bashkëpunim me fuqinë punëtore të kontraktorit do të sigurohet që punimet të realizohen në cilësinë e duhur dhe sipas grafikut të punimeve.

Inxhinier Hidroteknik – për punimet e rrjetit të kanalizimit të ujrave të zeza dhe të bardha

Inxhinier Topograf/ Gjeodet/ Markshajder – për punimet e piktimit

Teknik ndërtimi - është i nevojshëm pasi do të merret me organizimin e punimeve në bashkëpunim me inxhinierin e ndërtimit, si dhe në bashkëpunim me fuqinë punëtore të kontraktorit do të sigurohet që punimet të realizohen në cilësinë e duhur dhe sipas grafikut të punimeve.

2.4.3 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar te cilet duhet te figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për tre muajt e fundit, Për secilin duhet të paraqiten: Kontratë individuale të punës dhe Diplomë/certifikate:

- 1 (një) punonjes të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Argumentimi Kërkesat e mësipërme janë vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesat e mësipërme mbështeten në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë"; V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"; ligjin Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe ne mbështetje te pikës 4 te nenit 49 te Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të

shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga zjari apo çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

2.4.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muaj të fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 3 punëtorë asfalti
- 2 elektrikista
- 2 pllakashtrues
- 4 shoferë kamioni
- 1 betonues
- 1 hidraulik
- 1 karpentier

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar sipas pikës 2.4.2, (kapaciteti teknik në DST). Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë stafin teknik të mësipërm, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit, për natyrën komplekse të nderhyrjeve në këte veper e cila parashikon jo vetem nderhyrje të tipit rrafshim strukturor por dhe ndertime të reja komplekse të natyrave të punës dhe materialeve të shumëllojshme (b/a, metalike etj)

Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik, gjë e cila

është kërkuar për të garantuar AK për cilësinë e punimeve që do të kryhen si dhe të garantojë që proceset kryesore të punës të kryhen nga specialistët përkatës. Përzgjedhja e stafit të mësipërm është bërë bazuar në zbërthimin e preventivit sipas orëve të punës si dhe bazuar në eksperiencat e mëparshme të AK. Kërkesa për stafin teknik për punimet elektrike është mbështetur gjithashtu edhe në “Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike” ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmive të kualifikimit të sigurimit teknik.

2.4.5 Një punësim mesatar i të paktën **25 (njëzet e pese)** personave (përfshirë stafin teknik drejtues dhe mbështetës, punëtorët dhe manovratorët), të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 muajt e fundit.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit të deklaruar.

Shënim: Për përmbushjen e kësaj pike operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8. Dokumentacioni i kërkuar më sipër do të paraqitet fizikisht nga operatori fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit.

Argumentim: *Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Numri i punonjesve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjesve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrëndhëpërmasat e kontratës. Deklarim i detyrues i punonjesve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, përrjedhojë e detyrues me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrëndhëpërmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjesve. Vendosija e kriterit për një punësim të

paktën 30 persona duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhenpunimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët në për mjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar ne VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Pë rmiratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018).

Punetoria				
Kategoria	Njesia	Op preventivi	Op grafiku I punimeve	Numri
Punetori e specializuar (afaltin, betonin, trotuaret, tubacionet etj.)	op	17,531.45	1152	15.2
Punetori e paspecializuar (germimet, mbushjet me rere, mbushjet me cakell)	op	702.02	1152	0.6

Gjithashtu, përpara publikimit të njoftimit të fituesit, për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj eshte kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

2.4.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (katër) punonjës manovrator, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, Dëshmi e Aftësisë Profesionale (të vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. **(Në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).**

Shënim: Për përmbushjen e kësaj pike operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pare duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar , Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar Manovrator me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. ***Gjithashtu me qëllim nxitjen e konkurrencës është përcaktuar rasti përjashtimor ku për Manovratorët dhe shoferët që janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.***

2.5 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) per objektin qe prokurohet, si me poshte

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- b) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015(e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*,si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Përmiratimin e

rregullavetëprokurimit publik”i ndryshuar,kupërcaktohet se:“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 6 (gjashte muaj) muaj kalendarike.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

2.7 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencat profesionale të mëposhtme:

Licencë nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve”.

- Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë me një landfill të vlefshme deri në përfundimin e punimeve sipas grafikut.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë mbështetet në faktin që sipas punimeve të parashikuara në preventiv do të kemi punime gërmimi.

2.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 10 (dhjetë) ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 18 (tetëmbëdhjetë) ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë 3.5 – 5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion min 7 (shtatë) ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Rul me vibrim	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobitumatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadromë	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri vijëzimi	1 copë	Pronësi ose me qera
Rul me kompresor	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
Detektor i tensionit të lartë	1 copë	Pronësi ose me qera

- Kokore minimumi 24 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 2 copë
- Prozhektorë ndriçimi minimumi 2 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 2 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 copë
- Jeleke pune minimumi 24 cope

- (a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; - leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; sigurancin; leja e transportit e vlefshme dhe fotot përkatëse;
- (b) Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirave e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- (c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirave e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- (d) Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- (e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërmeeshtevendosursipaspikës 4, të Nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zerave përkatës të Preventivit. Numri i makinerve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit mundësive të manovrimit me mjete të renda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj si më poshtë:

Makinerve				
Lloji I makinerve	Njesia	Op preventivi	Op grafiku i punimeve	Numri
Eskavator me goma	op	804.64	1152	0.7
Rul me vibrim	op	677.78	1152	0.6
Autobot uji	op	138.55	1152	0.1

Grejder	op	117.32	1152	0.1
Autobitumatrice	op	11.63	1152	0.0
Asfaltoshtruese	op	98.86	1152	0.1
Rul me kompresor	op	98.86	1152	0.1
Betoniere 500 l	op	54.28	1152	0.0
Vibrator	op	80.88	1152	0.1
Matrapik	op	3.00	1152	0.0
Fadrome	op	138.69	1152	0.1
Makineri vijejimi	op	373.80	1152	0.3
Autovinc	op	1.50	1152	0.0

Transport						
		Sasia totale	Dite pune	Sasia e transportuar/dite	Sasia e transportuar ne 1 rruge	
Dhera	ton	11,725.60	144	81.43	16.29	5 rruge/dite
Rere, cemento, zhavorr, cakell, stabilizant	ton	5,027.42	144	34.91	8.73	4 rruge/dite
Asfalt, binder	ton	1,087.41	48	22.65	11.33	2 rruge/dite

Minieskavetori është kërkuar pasi duhet për të realizuar punimet e gërmimit në disa pjesë të rrugës të cilat janë shumë të ngushta dhe nuk aksesohen dot nga eskavatorët e mëdhenj.

Detektori i tensionit të lartë është kërkuar pasi dukë qenë se në territorin e zhvillimit të projektit kalon kabulli me tension 10 000V, prandaj duhet një pajisje e cila do të detektojë linjën e shtruar si dhe thellësinë në të cilën është vendosur, pasi ka qenë e pamundur nga ana jonë të gjejmë projektin e zbatuar.

Kamioncina 3.5 – 5 ton është kërkuar për transportin e materialeve elektrike dhe tubave të shkarkimit të ujrave të zeza dhe të bardha.

Pas përmbledhjes së makinerive sipas analizave teknike dhe shqyrtimit të grafikut të punimeve, si dhe duke gjykuar edhe nga mbivendosje e punimeve të ndryshme dhe eksperiencia e AK në zbatimin e punimeve janë përcaktuar makineritë e mësipërme.

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit(shtojca8) gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jete kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetë deklarimin e bërë gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar për çdo ze punimi të kësaj veprë sipas preventivit të hartuar nga projektuesi. Në specifikimet teknike nuk janë përmendur emra markash, me përjashtim të zërave të punës që përfshihen në manualin teknik të çmimeve, për të cilat operatorët ekonomikë mund të përdorin materiale ekuivalente.